



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1368/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Modus L.L.C., me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Afrim Salihu avokat në Prishtinë, kundër debitorit B&M SH.P.K., me seli në Q.T. Kodra e Diellit, K.II., nr.73, Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1945/2022 të datës 15.06.2023, me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Modus L.L.C., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1945/2022 i datës 15.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1945/2022 të datës 15.06.2023, ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit të përmbartimit B&M SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.631/2017 të datës 19.12.2017 të përmbartuesit privat Ilir Z. Mullhaxha me seli në Prishtinë, lidhur me shumën prej 2,360.00 Euro, në bazë të faturës nr.140 të datës 24.07.2017 të lëshuar nga kreditori i përmbartimit Modus LLC me seli në Prishtinë, si dhe ka përfunduar procedurën përmbartimore në këtë çështje lidhur me këtë faturë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, aktvendimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe të vendoset në ri procedurë sipas udhëzimeve të gjykatës ankimore.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Modus L.L.C., me seli në Prishtinë, me datë 19.12.2017, ka paraqitur propozim për përmbaerim, kundër debitorit B&M SH.P.K., me seli në Q.T. Kodra e Diellit, K.II., nr.73, Prishtinë, në bazë të dokumenti të besueshëm - faturës nr.140 të datës 24.07.2017 dhe faturës nr.160 të datës 09.10.2017, për shumën e përgjithshme në vlerë prej 3,540.00 Euro.

Përmbaeruesi privat Ilir Z. Mullhaxha, duke vepruar sipas propozimit për përmbaerim të kreditorit me urdhrin P.nr.631/2017 të datës 19.12.2017, ka lejuar përmbaerimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbaerim.

Kundër këtij urdhri përmbaerimor debitori me datë 12.01.2018 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbaerimor, me arsyetimin se, propozimi nuk i përmban objektin, llojin, vëllimin dhe kohën e përmbushjes së detyrimit, se faturat nuk janë pranuar nga debitori, gjegjësisht nuk janë të nënshkruara, gjë që e bën kërkesën të paarrtshme. Andaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi, të anulohet urdhri dhe të përfundohet në tërësi procedura përmbaerimore.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 16.01.2018, duke e kundërshtar prapësimin e debitorit, me arsyetimin se faturat janë dokument i besueshëm, kanë përmbajtjen e përcaktuar me ligj dhe se ato i janë dorëzuar debitorit përmes e-mailit. Andaj ka propozuar që të hudhet poshtë si jo i ligjshëm prapësimi i debitorit, ashtu që urdhri përmbaerimor të lihet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.81/2018 të datës 28.02.2018, me të cilin ka aprovuar pjesërisht prapësimin, ka shfuqizuar urdhrin sa i përket shumës prej 2.360 Euro sipas faturës së kreditorit nr.140 të datës 24 korrik 2017 dhe ka refuzuar prapësimin duke e lënë në fuqi urdhrin sa i përket shumës prej 1.180 Euro sipas faturës së kreditorit nr.160 të datës 09.10.2017. Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur kreditori sa i përket pjesës së shfuqizuar të urdhrin P.nr.631/2017 të datës 19.12.2017, meqenëse për pjesën e refuzuar nuk kishte interes juridik, ndërsa Gjykata e Apelit duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës ankuese, me aktvendimin Ac.nr.6272/2020 të datës 19.01.2022, ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit, ka prish aktvendimin e ankimuar PPP.nr.81/2018 të datës 28.02.2018 sa i përket pikës I dhe për këtë pjesë çështjen e ka kthyer në rigjykim, ndërsa pikën II të dispozitivit të aktvendimit PPP.nr.81/2018 të datës 28.02.2018 e ka lënë të pashqyrtuar. Me arsyetimin që në ri procedurë të vlerësohet fatura kontestuese dhe komunikimet ndërmjet palëve ndërgjyqëse.

Në procedurën e rishqyrtimit, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë pas vlerësimit të provave të administruara ka marr aktvendimin KPPP.nr.1945/2022 të datës 15.06.2023, me të cilin ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit të përbarimit B&M SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka anuluar urdhrin përbarimor P.nr.631/2017 të datës 19.12.2017 të përbaruesit privat Ilir Z. Mulhaxha me seli në Prishtinë, lidhur me shumën prej 2,360.00 Euro, në bazë të faturës nr.140 të datës 24.07.2017 të lëshuar nga kreditori i përbarimit Modus LLC me seli në Prishtinë, si dhe ka përfunduar procedurën përbarimore në këtë çështje lidhur me këtë faturë., duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në ri procedurë pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim, shkresave të lëndës dhe duke ka marr për bazë sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar, për arsye se fatura nr.140 e datës 24.07.2017 e lëshuar nga kreditori, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së, për faktin se kjo faturë në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit e as vulën e debitorit si dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori në cilëndo formë. Tutje gjykata ka arsyetuar se ka vlerësuar pretendimet e kreditorit se fatura nr.140 e datës 24.07.2017 në rastin konkret i është dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit përmes komunikimit elektronik – emailit, mirëpo ka gjetur se pretendimi i tillë është i pabazuar, për faktin se nga shkresat e lëndës nuk është provuar në asnjë mënyrë se debitori përmes e-mailit ose në ndonjë formë tjetër e ka konfirmuar pranimin e faturës nr.140 të datës 24.07.2017 të lëshuar nga kreditori. Përveç kësaj, as nga kontrata për pjesëmarrjen e kompanisë “B&B” SH.P.K., në Beerfest Kosova 7-2017 e lidhur më 20 korrik 2017 ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk rrjedhë se dorëzimi i faturave ose dokumenteve tjera përmes e-mailit do të konsiderohet dorëzim i rregullt për palët kontraktuese. Andaj, gjykata ka konstatuar se duke qenë se nuk ka prova se debitori e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, rezulton se ajo nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përbarueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale, në këtë rast debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga fatura kontestuese.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimin të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dhoma e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se fatura nr.140 e datës 24.07.2017, në shumë prej 2,360.00 Euro, e lëshuar nga ana e kreditorit nuk përmban nënshkrim

nga debitori. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit 29 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, i cili përcakton se: *Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe **faturë kthyesë**, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës”,* kurse me paragrafin 3 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore, kjo gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura nr.140 e datës 24.07.2017, në shumë prej 2,360.00 Euro si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura nr.140 e datës 24.07.2017 nuk e përmban nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbarueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Që nënkupton se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Së këndejmi, edhe Dhomat e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Gjykata ankimore ka shqyrtuar pretendimet e autorizuarit të kreditorit lidhur me atë se nga gjykata e shkallës së parë nuk janë vlerësuar komunikimet me e-mail dhe me viber të palëve ndërgjyqëse për faturën kontestuese, mirëpo të njëjtat kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara dhe të paprovuara me provat, për faktin se nga shkresat e lëndës nuk rezulton të ketë konfirmimin të e-mailit për faturën kontestuese nga debitori të cilat ju referohet kreditori dhe me asnjë formë tjetër të komunikimit nuk është provuar nga kreditori se debitori ka pranuar borxhin sipas faturës kontestuese.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore të palës ankuese, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të

dispozitive të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1368/2023, me datë 20.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha